



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2333/6 prot.

Datë 09/11/2022

V E N D I M
Nr. 10912022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09/11/2022 shqyrtoi kërkesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatorët ekonomikë “MUCA” SHPK dhe “RO-AL” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur - mallra”, me Nr. REF-41163-09-09-2022, me objekt “F.V mobilim Spitalor Spitali Kukës ”, me fond limit 19.840.000 Lekë pa TVSh, zhvilluar me datë 03.10.2022 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kukës.

Ankimues: Operatori ekonomik “Klame” SHPK
Adresa: Njësia Administrative 11, Kodër-Kamëz, Rruga “Gani Kryeziu”, Nr. 23, Kati i Dytë, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kukës
Adresa: Lagjia nr.7 Qyteti -Kukës.

Persona të interesuar: Operatori ekonomik “RO-AL” SHPK
Adresa: Km.8 Autostrada Tiranë-Durrës, Kashar, Tiranë.

Operatori ekonomik “MUCA” SHPK
Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, km.13, fshati Picar, Picar, Vorë, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlëra limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 12.09.2022 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur - mallra”, me Nr. REF-41163-09-09-2022, me objekt “F.V mobilim Spitalor Spitali Kukës”, me fond limit 19.840.000 Lekë pa TVSh, zhvilluar me datë 03.10.2022 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kukës.

II.2. Në datë 03.10.2022, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimimi.

II.3. Në datën 17.10.2022, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. "BUNA" SHPK	0 lekë	skualifikuar
2. "EUROMED" SHPK	0 lekë	skualifikuar
3. "BIOMETRIC ALBANIA" SHPK	0 lekë	skualifikuar
4. "MUCA" SHPK	16,837,300 lekë	kualifikuar
5. "RO-AL" SHPK	17,995,300 lekë	kualifikuar
6. "KLAME" SHPK	18,649,623 lekë	kualifikuar
7. "BOLT" SHPK	18,861,500 lekë	kualifikuar
8. "CFO PHARMA" SHPK	19,555,555 lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 19.10.2022, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit për procedurën e prokurimit në sistemin elektronik të prokurimeve, duke shpallur fituese ofertën e shoqërisë "MUCA" SHPK.

II.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 25.10.2022 operatori ekonomik ankimues "Klame" SHPK ka paraqitur njëkohësisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, duke ngritur pretendime për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik "MUCA" SHPK dhe ofertës së operatorit ekonomik "RO-AL" SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

II.6. Në përputhje me nenin 112 "Veprimet paraprake" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 2333/2 datë 26.10.2022, lidhur me kriteret të cilat operatori ekonomik ankimues "Klame" SHPK, pretendon se nuk përmbushen nga operatorët ekonomikë "MUCA" SHPK dhe "RO-AL" SHPK, pjesëmarrës në procedurë.

II.7. Me datë 31.10.2022, operatori ekonomik "MUCA" SHPK ka paraqitur argumentat e tij pranë Komisionit të Prokurimit Publik lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "Klame" SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, ku ndër të tjera ka argumentuar si në vijim: "... *Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit dorëzuar nga ana jonë në këtë procedurë është në përputhje të plotë me parashikimet ligjore. Për çdo deklaram të bërë nga ana jonë në të gjitha pikat e këtij formulari "MUCA" SHPK disponon vërtetimet dhe dokumentat përkatëse të cilat vërtetojnë deklaramet tona. Megjithëse AK neve si OE "MUCA" SHPK i renditur i pari nuk na ka kërkuar akoma dokumentat e ofertës dhe dokumentat në funksion të formularit të vetëdeklarimit.*"..

II.8. Në datën 07.11.2022 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 2333/5 prot., shkresa e autoritetit kontraktor me nr. 2242 prot., datë 02.11.2022 me objekt:

“Dërgimin dokumentacioni”, bashkëngjitur vendimi i autoritetit kontraktor nr. 1, datë 02.11.2022 për mospranimin e ankesës së shoqërisë “Klame” SHPK.

II.9. Nga shqyrtimi i informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se ky i fundit nuk e ka pranuar ankesën e operatorit ekonomik “Klame” SHPK, si më poshtë vijon:

“[...]

Pasi u mor në shqyrtim ankesa e paraqitur nga OE “KLAME” shpk parashtrimet me shkrim të ankimesit, dokumentacionin e paraqitur nga Autoriteti Kontraktor (AK) Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kukës, Komisioni i Sshqyrtimit të Ankesave.

VËEREN:

I.1. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku është publikuar me datë 26.10.2022 pranimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik.

I.3. Ankimesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Rrethana e çështjes;

Me datë 19.09.2022 në Buletinin e njoftimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) Nr. 129 është publikuar njoftimi i kontratës për prokurimin:

- *Me objekt* “F.V mobilim Spitalor Spitali Kukës”
- *Fondi limit:* 19.840.000 leke pa TVSH
- *Numri i referencës së procedurës:* REF-41163-09-09-2022
- *Data e zhvillimit tenderit:* 03.10.2022
- *Ora:* 13:00

Në këtë procedurë prokurimi deri në datë 03.10.2022, ora 13:00 paraqitën ofertat dhe dokumentacionin administrativo-ligjor 8 (tetë) operatorë ekonomikë, si më poshtë vijon:

<i>1. BUNA Shpk</i>	<i>J61826501C</i>
<i>Vlera e ofertës 0 (zero) lekë (pa tvsh)</i>	
<i>2. EUROMED Shpk</i>	<i>K71718012P</i>
<i>Vlera e ofertës 0 (zero) lekë (pa tvsh)</i>	
<i>3. BIOMETRIC ALBANIA Shpk</i>	<i>J61827062E</i>
<i>Vlera e ofertës 0 (zero) lekë (pa tvsh)</i>	
<i>4. MUCA Shpk</i>	<i>K01421002H</i>
<i>Vlera e ofertës 16,837,300 (gjashtëmbëdhjete milion e tetëqind e tridhjetë e shtatë mijë e treqind) lekë (pa tvsh)</i>	

5. "RO -AL" Shpk J61811001M
 Vlera e ofertës 17,995,300 (shtatëmbëdhjete milion e nëntëqind e nëntë dhjetë e pesë mijë e treqind) lekë (pa tvsh)
6. KLAME Shpk K21518003F
 Vlera e ofertës 18,649,623 (tetëmbëdhjete milion e gjashtëqind e dyzet e nëntë mijë e gjashtëqind e njëzet e tre) lekë (pa tvsh)
7. BOLT Shpk K91517011V
 Vlera e ofertës 18,861,500 (tetëmbëdhjete milion e tetëqinde e gjashtë dhjetë e një mijë e pesëqind) lekë (pa tvsh)
8. CFO PHARMA Shpk K22305002U
 Vlera e ofertës 19,555,555 (nëntëmbëdhjete milion e pesëqind e pesë dhjetë e pesë mijë e pesë qind e pesë dhjetë e pesë) lekë (pa tvsh).

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) mori në shqyrtim dokumentacionin e paraqitur nga subjektet ekonomike pjesëmarrëse në procedurën e prokurimit me objekt: "F.V mobilim Spitalor Spitali Kukës" dhe me procesverbalin nr. 2, datë 17.10.2022 ka vlerësuar ofertat e operatorëve ekonomikë si më poshtë:

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. BUNA Shpk J61826501C
 Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-t
 Vlera e ofertës 0 (zero) lekë (pa tvsh)
 Përkatësisht për arsyet e mëposhtme: nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion kualifikues për këtë procedurë prokurimi.
2. EUROMED Shpk K71718012P
 Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it
 Vlera e ofertës 0 (zero) lekë (pa tvsh)
 Përkatësisht për arsyet e mëposhtme: nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion kualifikues për këtë procedurë prokurimi.
3. BIOMETRIC ALBANIA Shpk J61827062E
 Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it
 Vlera e ofertës 0 (zero) lekë (pa tvsh)
 Përkatësisht për arsyet e mëposhtme: nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion kualifikues për këtë procedurë prokurimi.

Ndërsa për subjektet pjesëmarrëse në këtë prokurim të cilët përmbushin kërkesat e vendosura nga autoriteti kontraktor, sipas DST-ve, KVO ka bërë renditjen dhe klasifikimin si më poshtë:

Nr.	Emri i Subjektit (Operatorit ekonomik)	NIPT-i (Nr. Identifik.Tatimor)	Vlera e Ofertës e çmimeve për njësi (Pa Tvsh) leke	Renditja e ofertuesve ne klasifikimin përfundimtar
1	"MUCA' SHPK	K01421002H	16.387.300	I pari
2	"RO-AL" SHPK	J61811001M	17.995.300	I dyti

3	"KLAME" SHPK	K21518003F	18.649.623	I treti
4	"BOLT" SHPK	K91517011V	18.861.500	I katërta
5	"CFO PHARMA" SHPK	K22305002U	19.555.555	I pesti

5. Operatori ekonomik "KLAME" SHPK duke mos qënë dakort me vlerësimin e bërë nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor si dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në zbatim të nenit 111, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", ku ngre pretendime mbi arsyet e ankimit që janë si më poshtë:

PRETENDIMET E "KLAME" SHPK

- Për mospërmbushje nga ana e operatorit ekonomik "MUCA" SHPK dhe operatorit ekonomik "RO-AL" SHPK, Shtojca 7 "FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT", "Kriteret e veçanta të kualifikimit", Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8.

Më datë 01.11.2022 pranë autoritetit kontraktor është depozituar shkresa "Argumente shtesë" protokolluar me tonën me nr. 2232, datë 01.11.2022 e operatorit ekonomik "MUCA" SHPK, duke bashkëngjitur dokumentat shtesë siç janë përshkruar në Formularin e Vetëdeklarimit.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm, shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si dhe argumentave të paraqitura nga OE "MUCA" SHPK

ARSYETON:

1. Ankesa e paraqitur nga OE "KLAME" SHPK për procedurën e prokurimit me objekt "F.V mobilim Spitalor Spitali Kukës ", me Nr. REF-41163-09-09-2022, ku ngrihen pretendime për mospërmbushje nga ana e operatorit ekonomik "MUCA" SHPK dhe operatorit ekonomik "RO-AL" SHPK Shtojca 7 "FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT", "Kriteret e veçanta të kualifikimit", Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8, rezulton se:

Në datën 09.09.2022 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit "E Hapur" mallra me objekt: "F.V mobilim Spitalor Spitali Kukës ", me fond limit 19.840.000 leke pa TVSH, me nr. REF-41163-09-09-2022, publikuar me datë 19.09.2022, zhvilluar në datë 03.10.2022 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kukës.

Me procesverbalin nr. 2, datë 17.10.2022 Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka bërë vlerësimin në SPE të ofertave me renditjen si më poshtë:

Nr.	Emri i Subjektit (Operatorit ekonomik)	NIPT-i (Nr. Identifik.Tatimor)	Vlera e Ofertës e çmimeve për njësi (Pa Tvsh) leke	Renditja e ofertuesve ne klasifikimin përfundimtar
1	"MUCA' SHPK	K01421002H	16.387.300	I pari
2	"RO-AL" SHPK	J61811001M	17.995.300	I dyti
3	"KLAME" SHPK	K21518003F	18.649.623	I treti
4	"BOLT" SHPK	K91517011V	18.861.500	I katërti
5	"CFO PHARMA" SHPK	K22305002U	19.555.555	I pesti

Pas vlerësimit autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin paraprak të fituesit në SPE referuar Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" si dhe Udhëzimin nr. 07, datë 30.07.2021 "Për mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike".

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE rezulton se:

Opërori ekonomik "MUCA' SHPK dhe operatori ekonomik "RO-AL" SHPK përmbushin të gjitha kërkesat për kualifikim të vendosura nga autoriteti kontraktor në DST (Shtojca 7 Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit) referuar Formularit të Vetëdeklarimit të plotësuar nga secili OE dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik "MUCA" SHPK dhe operatori ekonomik "RO-AL" SHPK vërehet se janë plotësuar në mënyrë korrekte të gjitha fushat e kërkuara në formular, si dhe është plotësuar pjesa e fundit e formularit ku kërkohet data e dorëzimit, emri, mbiemri, firma, si dhe vula e shoqërisë. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga OE "MUCA" SHPK dhe OE "RO-AL" SHPK në procedurën e prokurimit plotësojnë kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes nuk qëndron.

2. Në lidhje me pretendimin për parregullsi procedurale në zhvillimin e kësaj procedure prokurimi duke ngarkuar në SPE 2 (dy) dokumenta ëordi.

Sqarojmë operatorin ekonomik "KLAME" SHPK se në zbatim të LPP, neni 97, citohet se: "Menjëherë, por jo më vonë se 5 ditë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit të ofertave, autoriteti kontraktor publikon në sistemin e prokurimit elektronik njoftimin paraprak të fituesit. Me publikimin e njoftimit të fituesit në sistemin e prokurimit elektronik, operatorëve ekonomikë i lind e drejta e ankimit sipas parashikimeve të nenit 109, të ligjit.", autoriteti kontraktor ka ngarkuar njoftimin paraprak të fituesit më datë 17.10.2022, i cili është refuzuar për publikim nga Agjencia e Prokurimit Publik për arsye të gabimeve teknike, pas rregullimeve përkatëse autoriteti kontraktor ka ngarkuar njoftimin paraprak të fituesit më datë 18.10.2022, nga ky moment dhe në vazhdim AK nuk ka kërkuar nga operatori ekonomik "MUCA" SHPK i klasifikuar i pari dokumentacion për të paraqitur, pasi janë afatet e ankimit (në zbatim të nenit 110, pika 2 të Ligjit për Prokurimin Publik).

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për këto arsye:

Ndodhur para rrethanave dhe fakteve të analizuara më sipër, bazuar në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave.

VENDOSI

- 1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “KLAME” SHPK për procedurën e prokurimit me objekt: “F.V mobilim Spitalor Spitali Kukës ”, me nr. REF-41163-09-09-2022, zhvilluar më datë 03.10.2022*
- 2. Kundër këtij vendimi subjekti ka të drejtën e ankimit sipas afateve ligjore.”.*

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre,

Arsyeton

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik “KLAME” SHPK, në zbatim të nenit 29, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, në të cilin parashikohet se “1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përrjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre”, nisur nga pretendimet e ngritura nga ana e operatorit ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës ka lidhje me vendimet dhe veprimet e ndërrmarra kryesisht nga autoritetit kontraktor gjatë zbatimit të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.1.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “KLAME” SHPK, për skualifikimin e ofertës së tij me arsyet: “Në datë 03.10.2022, ora 13;00 është bërë hapja e tenderit objekt i kësaj ankese. Në datë 17.10.2022, ora 14:16 autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE klasifikimin me rezultatin e vlerësimit të procedurës. Po në SPE ndodhen 2 dokumenta ëordi NJOFTIME FITUESI ku njëri ka datën 17 dhe tjetri ka datën 18.10.2022 në brendinë e tij, si është e mundur që autoriteti kontraktor në të njëjtën ditë, madje brenda orës të njoftojë menjëherë FITUESIN e kësaj procedure prokurimi? Kujtojmë se kompania “MUCA” SHPK e ka dresën e selisë në autostradën Tiranë-Durrës dhe do i duheshin të paktën 2 orë që të shkojë në Kukës për të dorëzuar dokumentacionin e tenderit që ka paraqitur në SPE dhe atë që ka deklaruar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit që

më pas autoriteti kontraktor të zbatonte procedurën dhe të vijonte me nxjerrjen e Njoftimit të Fituesit sipa sparashikimit të LPP dhe të VKM nr. 285/2021. Theksojmë këtu që dokumentacioni që dorëzohet fizikisht pranë SK duhet të paraqitet në origjinal ose fotokopje e njëhësuar me origjinalin, pra që të përgatitet dokumentacioni i kërkuar nevojitet një kohë e caktuar. Theksojmë këtu që një pjesë e këtij dokumentacioni duhet të tërhiqet pranë Gjykatës, Prokurorisë, Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Tatimeve, etj, si ka mundësi që gjithçka ky OE e kishte gati? Theksojmë për KPP-në se ose autoriteti kontraktor nuk ka zbatuar fare ligjin dhe procedurën dhe afatet dhe ka vazhduar menjëherë publikimin e Njoftimit të Fituesit pa parë dokumentat e operatorit fizikisht, ose ka zbatuar procedurën por fituesi ka qënë paracaktuar dhe operatori i ka patur dokumentat gati për dorëzim menjëherë në të njëjtin moment sapo ka dalë renditja e ofertave në SPE, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.2. Në datën 12.09.2022 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur - mallra”, me Nr. REF-41163-09-09-2022, me objekt “F.V mobilim Spitalor Spitali Kukës ”, me fond limit 19.840.000 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 03.10.2022 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kukës.

III.1.3. Në datë 03.10.2022, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimimi.

III.1.4 Në datën 17.10.2022, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “BUNA” SHPK	0 lekë	skualifikuar
2. “EUROMED” SHPK	0 lekë	skualifikuar
3. “BIOMETRIC ALBANIA” SHPK	0 lekë	skualifikuar
4. “MUCA” SHPK	16,837,300 lekë	kualifikuar
5. “RO –AL” SHPK	17,995,300 lekë	kualifikuar
6. “KLAME” SHPK	18,649,623 lekë	kualifikuar
7. “BOLT” SHPK	18,861,500 lekë	kualifikuar
8. “CFO PHARMA” SHPK	19,555,555 lekë	kualifikuar

III.1.5. Në datën 19.10.2022, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit për procedurën e prokurimit në sistemin elektronik të prokurimeve, duke shpallur fituese ofertën e shoqërisë “MUCA” SHPK.

III.1.6. Referuar informacionit të autoriteti kontraktor protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me shkresën nr. 2333/5 prot, datë 07.11.2022, si dhe argumentave të paraqitura nga ana e operatorit ekonomik “MUCA” SHPK i shpallur fitues rezulton se autoriteti kontraktor nuk i është drejtuar këtij operatori ekonomik me kërkesën për të paraqitur dokumentacionin provues të deklarimeve të bëra në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të bëra prej tij në zbatim të nenit 26, pika 6 e VKM 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

III.1.7. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.8. Në Udhëzimin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 07, datë 30.07.2021 “Për mënyrën e zhvillimit të procedurave të prokurimit me mjete elektronike”, parashikohet shprehimisht se:

“3.7.Verifikimi i procedurës së vlerësimit të ofertave

Pas përfundimit të procesit të vlerësimit të ofertave nga komisioni i vlerësimit të ofertave, nëpunësi i autorizuar hyn në sistemin e prokurimit elektronik, duke shkruar llogarinë e tij të përdoruesit dhe fjalëkalimin e vlefshëm.

Më pas klikoni tek “Vendi i punës” në menunë kryesore. Tek skedari “Detyra të mbetura” nëpunësi i autorizuar duhet të klikojë tek faza “Vlerësimi i Ofertave”.

Në rast se, anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave, nuk kanë përfunduar akoma vlerësimin, atëherë sistemi do t’ju shfaq një mesazh i tillë:

Në rast se, të gjithë anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave, kanë përfunduar vlerësimin e procedurës sistemi do të shfaqë mesazhin e mëposhtëm:

Për të vazhduar më tej, nëpunësi i autorizuar duhet të klikojë butonin “Hapi Tjetër”.

Në këtë moment, sistemi në mënyrë elektronike dërgon raportin e klasifikimit tek të gjithë ofertuesit pjesëmarrës, si dhe në rastin e skualifikimit të një ofertuesi, sistemi dërgon në mënyrë elektronike njoftimin e skualifikimit duke përfshirë të gjitha arsyet e shënuara nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave.

Gjithashtu, tek vendi i punës së anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, tashmë procedura ka kaluar tek dosja “Vlerësuar” dhe nuk mund të bëhet asnjë ndryshim mbi

vlerësimin e procedurës por anëtarët e komisionit mund të shikojnë vlerësimin e tyre, si dhe të gjenerojnë Raportin Përmbledhës së Vlerësimit në sistem.

3.9. Krijimi dhe dërgimi për publikim i Njoftimit të Fituesit në SPE

Për të krijuar dhe dërguar për publikim njoftimin e fituesit, duhet të kryhen veprimet si më poshtë:

1. Krijohet dhe dërgohet për publikim nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik (në vijim “SPE”), formulari i njoftimit paraprak të fituesit, duke ndjekur hapat si më poshtë:

Nëpunësi i autorizuar pasi hyn në sistem, duhet të klikojë tek skedari “Detyra të mbetura” dhe tek faza “Kërkohet Ri-vlerësim” duhet të zgjedhë “Njoftim Fituesi” për të kaluar në krijimin në sistem të njoftimit paraprak të fituesit.”.

III.1.9. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji.** Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. **Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.**

III.1.10. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.**

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese

brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

III.1.13. Në interpretim të sa më sipër KPP gjykon, se autoriteti kontraktor ka detyrimin t'i kërkojë ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Në rastin konkret KPP vërën se momenti procedural i kërimit të dokumenteve origjinale dhe verifikimi i tyre nga ana e autoritetit kontraktor për operatorin ekonomik të kualifikuar i pari "MUCA" SHPK, duhet të ishte bërë përpara datës së publikimit të njoftimit të fituesit paraprak, por gjithmonë pas datës së publikimit të klasifikimit të ofertave, pra pas datës 17.10.2022, datë në të cilën referuar dhe sistemit prokurimeve elektronike rezultoi të jetë përmbyllur dhe procesi i vlerësimit të ofertave nga ana komisionit të vlerësimit të ofertave. Pasi dhe në Udhëzimin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 07, datë 30.07.2021 "*Për mënyrën e zhvillimit të procedurave të prokurimit me mjete elektronike*", parashikohet se: "**3.9. Krijimi dhe dërgimi për publikim i Njoftimit të Fituesit në SPE**

Për të krijuar dhe dërguar për publikim njoftimin e fituesit, duhet të kryhen veprimet si më poshtë:

1. *Krijohet dhe dërgohet për publikim nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik (në vijim "SPE"), formulari i njoftimit paraprak të fituesit, duke ndjekur hapat si më poshtë:*

Nëpunësi i autorizuar pasi hyn në sistem, duhet të klikojë tek skedari "Detyra të mbetura" dhe tek faza "Kërkohet Ri-vlerësim" duhet të zgjedhë "Njoftim Fituesi" për të kaluar në krijimin në sistem të njoftimit paraprak të fituesit." Pra nga sa më sipër rezultoi se autoriteti kontraktor nuk ka ndjekur hapat proceduralë të parashikuara dhe në udhëzimin e sipërcituar, ku thuhet se: "*Në këtë moment, sistemi në mënyrë elektronike dërgon raportin e klasifikimit tek të gjithë ofertuesit pjesëmarrës, si dhe në rastin e skualifikimit të një ofertuesi, sistemi dërgon në mënyrë elektronike njoftimin e skualifikimit duke përfshirë të gjitha arsyet e shënuara nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave."* dhe pas këtij veprimi procedural autoriteti duhej të kryente veprimet procedurale që parashikon neni 26 pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar, ku thuhet se **[...] Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni [...].** Referuar bazës ligjore të sipërcituar KPP gjykon se ligjvënësi ka përcaktuar një procedurë të caktuar për tu ndjekur nga ana e autoriteteve kontraktore, veprimi procedural i datës 19.10.2022, i kryer nga autoriteti kontraktor duke publikuar njoftimin e fituesit paraprak, ndërkohë që operatorit ekonomik të kualifikuar i pari "MUCA" SHPK nuk i është kërkuar paraqitja e dokumentacionit provues të deklarimeve të bëra prej tij në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, si dhe mosparaqitja e këtij dokumentacioni prej këtij të fundit, KPP e gjykon, të gabuar si zbatimin ashtu dhe interpretimin e ligjit në rastin konkret nga ana e autoritetit kontraktor, pasi në respektim të dispozitave të mësipërcituara autoriteti duhej që pas përfundimit të procesit të vlerësimit të ofertave më datë 17.10.2022 dhe përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak, **ti kërkonte ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni 26 të VKM 285, datë 19.02.2021**". Sikundër rezultoi, nga faktet e parashtruara më sipër, autoriteti kontraktor nuk ka respektuar hapat proceduralë të parashikuara nga ligji në lidhje me kërkimin e dokumentacionit, ofertuesit të kualifikuar i pari për të kryer verifikimin e kapaciteteve të cilat ishin përmbyllur deri në atë moment me

anë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në nenin 2 të tij, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Gjithashtu KPP gjykon, se ligjvënësi ka parashikuar afate strikte kohore për zhvillimin e procedurave të prokurimit në përgjithësi dhe në veçanti në lidhje me institutin e ankimit administrativ, të rishikimit të vendimmarrjes së autoritetit kontraktor. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor ka gabuar në zbatimin dhe interpretimin e ligjit në rastin konkret, pasi nuk ka marrë parasysh ndryshimet ligjore në lidhje me nenin 26 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, ku parashikohet shprehimisht se **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin.** Vendimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave i datës 19.10.2022 mbi publikimin e njoftimit të fituesit paraprak, është akt administrativ në kuptim të nenit 3 pika 1 të K.Pr.A, (ligji 44/2015) “*si do shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektsh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete*”. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se njoftimi i fituesit paraprak i datës 19.10.2022 në lidhje me shpalljen fitues të operatorit ekonomik ankimes “MUCA” SHPK pa dorëzuar pej këtij të fundit të dokumentacionit provues të deklarimeve të bëra prej tij në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, do të konsiderohen si akte absolutisht të pavlefshme pasi mos kërkimi i dokumentacionit nga ana e autoritetit kontraktor duke vijuar me publikimin e njoftimit të fituesit paraprak e bën atë absolutisht të pavlefshme si veprim procedural. Në nenin 108 të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, parashikon se “*Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme: a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me: i) kompetencën e organit publik; ii) procedurën e nxjerrjes së tij; ose iii) formën ose elementë të tjerë të detyrueshëm të aktit; b) është nxjerrë nëpërmjet mashtrimit, kanosjes, mitmarrjes, konfliktit të interesit, falsifikimit apo një veprimi tjetër që përbën vepër penale; c) ekzekutimi i aktit mund të shkaktojë një veprim të dënueshëm, sipas legjislacionit penal; ç) në çdo rast tjetër të parashikuar shprehimisht në ligj.*” Gjithashtu, në nenin 111 të K.Pr.A parashikohet se “*Organi publik ka detyrimin të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ nëse vjen në dijeni për rastet e parashikuara në nenin 108 të këtij Kodi*”. Ndër karakteristikat thelbësore të veprimit juridik absolutisht të pavlefshëm përmendim: (i) *veprimi juridik që është absolutisht i pavlefshëm nuk shkakton pasojat juridike që synojnë palët; (ii) ai nuk ka fuqinë juridike të një veprimi juridik të vlefshëm; (iv) veprimi juridik i pavlefshëm nuk mund të bëhet i vlefshëm me asnjë veprim të mëpasshëm, as edhe kur ekziston vullneti i palëve (me aprovim, miratim), as me kalimin e kohës së parashkrimit dhe as me zhdukjen më vonë të*

shkakut të pavlefshmërisë (quod ab initio vitiosum est tractu temporis convalescere non potest). Komisioni i Prokurimit Publik në interpretim sistematik (domethënien e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik), gjykon se ndodhet para kushtit të konstatimit prima facia të një akti administrativ absolutisht të pavlefshëm dhe në cilësinë e organit administrativ më të lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, parashikuar nga neni 24/1 i ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*”, konstaton se akti administrativ i Komisionit Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e operatorit ekonomik ankimues “*Gamma*” SHPK, dhe publikimi i njoftim anulimit i datës 23.06.2022 të procedurës së prokurimit objekt-ankimi nga autoriteti kontraktor, janë akt administrativ absolutisht i pavlefshëm në kuptim të nenit 108 të K.Pr.A. Sa më sipër, referuar nenit 110 të KPrA në të cilën parashikohet se “*Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë. Ai konsiderohet se nuk ekziston.*” autoriteti kontraktor duhet të marrë masat e nevojshme për kthimin e situatës juridike në gjendjen fillestare për operatorin ekonomik ankimues “*MUCA*” ShPK dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të kryejë veprimet procedurale në përputhje me parashikimet në udhëzimin nr. 07, datë 30.07.2021 “*Për mënyrën e zhvillimit të procedurave të prokurimit me mjete elektronike*”, në të cilin parashikohet se: “*Pas përfundimit të procesit të vlerësimit nga të gjithë anëtarët e KVO për të gjitha ofertat e dorëzuara nga operatorët ekonomikë. Në këtë moment sistemi iu dërgon në mënyrë elektronike automatikisht njoftimin mbi klasifikimin e gjithë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës*”, dhe me parashikimet e nenit 26 pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, ku thuhet se **[...] Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni [...].** Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se hapat proceduralë të ndjekur nga autoriteti kontraktor për procedurën e prokurimit objekt-prokurimi cenojnë në thelb jo vetëm garancitë procedurale të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, por njëherazi cenojnë edhe parimin e sigurisë juridike. Në jurisiprudencën e saj *Inter Allia*, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në vendimin nr. 12/2014 datë 17.03.2014 është shprehur se “*Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin*”. Sa më sipër, KPP gjykon, se në rastin konkret parimi i sigurisë juridike në kuptimin material të tij, konsiderohet edhe moscenimi i të drejtave të fituara dhe i pritshmërive të ligjshme që garantojnë aktet në fuqi. Akoma më tej, në jurisiprudencën e saj, Gjykata Kushtetuese *Inter Allia* në vendimin 15/2010 ka theksuar se “*parimi i shtetit të së drejtës i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës nënkupton veprimin e të gjithë institucioneve shtetërore sipas së drejtës në fuqi si dhe supremacinë e Kushtetutës ndaj akteve të tjera normative. Çdo organ në një shtet të së drejtës duhet të veprojë për aq sa i lejon Kushtetuta dhe ligji duke mos i tejkaluar kufijtë e përcaktuar prej tyre. Në këtë kuptim, çdo institucion shtetëror duhet të ketë të përcaktuar qartë fushën e kompetencave të veta brenda të cilave është i autorizuar të veprojë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore*”. Sa më sipër, K.P.P. njoftimi i fituesit paraprak i datës 19.10.2022 dhe vendimi nr.1, i datës 02.11.2022 i Komisionit Shqyrtimit të Ankesave mbi ankesën e operatorit ekonomik ankimues “*KLAME*” SHPK, si një akt administrativ individual, i shtrin efektet *inter parties* dhe në asnjë rast *erga omnes*. Ndaj KPP, gjykon se këto vendime janë në kundërshtim me

hapat proceduralë që parashikon LPP, ndaj këto vendime duhet të anulohen si vendime të dala në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik.

Sa më sipër, KPP gjykon, se publikimi i njoftimit të fituesit paraprak për operatorin ekonomik “MUCA” SHPK është kryer në shkelje të parashikimeve ligjore aktualisht në fuqi dhe se zyrtari/ët përgjegjës të këtij autoriteti kontraktor kanë kryer shkelje të qëllimshme të rregullave të prokurimit publik. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor mënjëherë pas shpalljes së klasifikimit të ofertave përpara se të publikonte njoftimin e fituesit duhej t’i **kërkonte ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese** për të bërë të mundur verifikimin e dokumentacionit origjinal të ankimuesit me atë të deklaruar në formularin e vetdeklarimit. KPP veprimin e datës 19.10.2022 të autoritetit kontraktor e gjen, jo në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi. KPP i tërheq vëmendjen autoritetit kontraktor, për mosrespektim të dispozitave ligjore në fuqi, lidhur me momentin procedural të verifikimit të dokumentacionit origjinal në shkelje të afateve ligjore. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor për procedurat e prokurimit të cilat realizon, duhet të garantojë respektimin e parashikimeve ligjore në fuqi dhe parimeve të transparencës dhe efikasitetit parashikuar në nenin 2 të LPP-së. Në këtë kuptim, KPP e gjen publikimin e njoftimit të fituesit paraprak për operatorin ekonomik “MUCA” SHPK, të pabazuar në ligj dhe në kapërcim të afateve ligjore në fuqi.

Për sa më sipër pretendimi i mësipërm i operatorit ekonomik ankimues “KLAME” SHPK qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të paraqitura nga operatori ekonomik “KLAME” SHPK, Komisioni Prokurimit Publik gjykon, se nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës administrative, për sa kohë që procedura e prokurimit objekt-ankimi do të rikthehet në gjendjen fillestare dhe të rivlerësohet vetëm për operatorin ekonomik “MUCA” SHPK, për shkak se autoriteti kontraktor nuk ka ndjekur hapat proceduralë që i ngarkon ligji për vlerësimin e operatorit ekonomik “MUCA” SHPK. Gjendja faktike dhe juridike e operatorëve të tjerë ekonomikë pjesëmarrës nuk duhet të ndryshojë nga ajo e datës 17.09.2022, edhe pas publikimit të njoftimit të fituesit paraprak që do të kryhet nga ana e autoritetit kontraktor në zbatim të këtij vendimi operatorët ekonomikë kanë të drejtë sërish për të kundërshtuar vendimet e autoritetit kontraktor.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “*KLAME*” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur - mallra*”, me Nr. *REF-41163-09-09-2022*, me objekt “*F.V mobilim Spitalor Spitali Kukës* ”, me fond limit 19.840.000 Lekë pa TVSh, zhvilluar me datë 03.10.2022 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kukës.
 2. Të mos marrë në shqyrtim pretendimet e tjera të operatorit ekonomik “*KLAME*” SHPK, për skualifikimin e ofertës së shoqërisë “*MUCA*” SHPK dhe ofertës së shoqërisë “*RO-AL*” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.
 3. Të konstatoj absolutisht të pavlefshëm vendimin e Komisionit Vlerësimit të Ofertave të datës 19.10.2022 për shpalljen fitues të operatorit ekonomik “*MUCA*” SHPK, si vendim absolutisht të pavlefshme të marrë në kundërshtim me hapat proceduralë që parashikon ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, dhe të rikthejë procedurën në gjendjen fillestare vetëm për këtë operator ekonomik në mënyrë që të kryejë vlerësimin e tij në përputhje me parashikimet e udhëzimit nr. 07, datë 30.07.2021 “*Për mënyrën e zhvillimit të procedurave të prokurimit me mjete elektronike*”, dhe parashikimet e nenit 26 pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”.
 4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.
 5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*KLAME*” SHPK.
 6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri